



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 210, Datë 27.09.2018

MBI

**LICENCIMINE SHOQËRISË “AEE” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e datës 27.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me Vendimin nr. 192, datë 30.08.2018, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “AEE” sh.p.k. në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 55/56 Prot., datë 30.08.2018, ka bërë njoftimin në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 549/1 Prot., datë 03.09.2018, ka përcjellë pranë subjektit “AEE” sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës.
- Aplikimi i shoqërisë “AEE” shpk, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjise elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI